



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova
Agency for the Management of Memorial Complexes of Kosovo

DATË/A:	30.03.2022
REFERENC-Ë:	35.03.22
PËR/ZA/TO:	Glauk Konjufca, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
CC:	Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bislim Zogaj / Drejtor i AMKMK-së 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Vjetor i Performancës për vitin 2021

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Në pajtim me nenin 43, paragrafi 5. të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, iu procedojmë Raportin Vjetor të Performancës së AMKMK-së për vitin 2021.

Bashkëngjitur me këtë Raport Vjetor keni edhe:

- Raportin Financiar të AMKMK-së për vitin 2021.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova
Agency for the Management of Memorial Complexes of Kosovo

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË AMKMK-SË PËR VITIN 2021

1. Përmbledhje Ekzekutive	4
2. Korniza Ligjore.....	5
3. Përshkrimi i Institucionit	6
3.1. Kompetencat e Agjencisë:.....	6
3.2.Vizioni i AMKMK-së:.....	6
3.3.Misioni i AMKMK-së:	6
4. Fushëveprimi që e mbulon Institucioni	7
4.1. Organogrami i AMKMK-së.....	8
4.2. Numri i të Punësuarve në AMKMK - 2021	9
4.3. Asetet	10
4.4. Hapësira për punë	10
5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese.....	11
5.1.Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2021:	13
5.1.1 Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.....	13
5.1.2. Divizioni për Buxhet dhe Financa	13
5.1.3.Divizioni Ligjor	14
5.1.4.Divizioni për TI, GIS dhe Logjistikë	14
5.1.5. Divizioni i Prokurimit:	14
5.1.6. Divizioni i Burimeve njerëzore.....	18
5.1.7. Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim:	18
5.2.Planet që parashikohen për vitin 2022.....	22
5.2.1.Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	22
5.2.2. Divizioni për buxhet dhe financa.....	23
5.2.3. Divizioni Ligjor	23
5.2.4. Divizioni për TI, GIS dhe Logjistikë	24
5.2.5. Divizioni i Prokurimit.....	24
5.2.6. Divizioni i Burimeve Njerëzore.....	25
5.2.7. Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim	25
5.3. Përmirësimet dhe monitorimi i fushës së veprimit	26
6. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / Sfidat e Institucionit (Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit).....	27
7. Raporti Financiar	30
8. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm	31
9. Shtojcat	32
Shtojca Nr. 1. Asetet që posedon AMKMK-ja	34
Shtojca Nr. 2. Plani i Aseteve për vitin 2022.....	52

1. Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK), është institucion i pavarur që merret me planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. Kjo Agjenci është themeluar në vitin 2013, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-146 të AMKMK-së dhe pas publikimit në Gazetën Zyrtare GZK/Nr.9/ më datë 26.04.2013.

Agjencia për punën e vet i raporton një herë në vit komisionit parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis të Kuvendit të Kosovës (KBPZHRIM). Në vazhdim, AMKMK do të paraqesë Raportin Vjetor përkitazi me të gjitha aktivitetet lidhur me zbatimin e Ligjit të AMKMK-së.

Prandaj, në këtë raport vjetor do të paraqiten arritjet e agjencisë për vitin 2021 si dhe objektivat dhe sfidat për vitin 2022.

Arritjet e AMKMK-së për vitin 2021 janë: realizimi i projekteve sipas Ligjit të Buxhetit të vitit 2021, ekzekutimi i planit të prokurimit, zbatimi i planit të personelit dhe përmbushja e kornizës ligjore.

Ndërkaq, objektivat e parashikuara nga agjencia për vitin 2022 janë:

- Realizimi i buxhetit sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2022;
- Zbatimi i planit të personelit;
- Planifikimi, hartimi dhe menaxhimi i Komplekseve dhe Memorialëve;
- Zbatimi i planit të prokurimit;
- Zgjerimi i rrjetit të mirëmbajtjes së Komplekseve Memoriale;
- Hartimi i projekt strategjisë dhe planit të veprimit të AMKMK-së;
- Realizimi i shpronësimit të pronave ku gjenden Komplekset Memoriale, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Infrastrukturës në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Kurse sfidat kryesore për vitin 2022 janë:

- Mungesa e Buxhetit të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e Komplekseve dhe Memorialeve;
- Mungesa e stafit të mjaftueshëm profesional;
- Bashkëpunimi ndërinstitucional;
- Zgjidhja e çështjeve pronësore juridike e pronave në Komplekse dhe Memoriale.

2. Korniza Ligjore

Baza ekzistuese ligjore që e rregullon fushëveprimtarinë e Agjencisë është Ligji Nr.04/L-146 për AMKMK-në (GZRK) Nr.9/ 26 Prill 2013.

Ligj tjetër është Ligji Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz (GZRK) Nr.19/ 13 Nëntor 2018.

Lidhur me këto dy Ligje deri me tani nuk kemi pasur ndonjë ndryshim, plotësim.

Në zbatim, nuk ka pasur vështirësi lidhur me Ligjin Nr.04/L-146 për AMKMK dhe Ligjin Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës funksionon në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Në AMKMK janë nxjerrë këto Akte Nënligjore:

Tabela 1. Aktet nënligjore

Ligji Nr.04/L-146 AMKMK	1. Udhëzim Administrativ Nr.01.2014 për Stemën e AMKMK-së
	2. Rregullore nr.05/2016 për Punët në Teren, Punët shtesë
	3.Rreg.Nr.01/2020 për Caktimin e Shpenzimeve të Telefonave Fiks dhe Mobil të AMKMK-së
	4. Rregullore Nr.06/2017 për Krijimin e të Hyrave
	5. Rreg.Nr.01/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në AMKMK
Ligji Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.	Rregullore (QRK) Nr.01/2021 për Rregullat dhe Mënyrën e Sjelljes së Vizitorëve në Hapësirat e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

3. Përshkrimi i Institucionit

Agjencia është organ i pavarur për projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale.

Agjencia e ka stemën e cila përkufizohet me akt nënligjor.

3.1. Kompetencat e Agjencisë:

Agjencia është përgjegjëse për:

- Projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- Përcaktimi i programeve kërkimore - shkencore, aktivitete dhe manifestime të ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- Bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitatet përkatëse, Agjencitë turistike për projektet që kanë të bëjnë me këto zona dhe OJQ-të;
- Krijimin e Web-Faqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale si dhe publikimin e revistës vjetore;
- Inicimin e procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitjen e propozim vendimit për miratim në Kuvend;
- Hartimin e planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- Hartimin e planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;
- Propozon shpalljen e zonave me interes të veçantë kombëtar dhe me karakter historik.

3.2. Vizioni i AMKMK-së:

Vizioni i AMKMK-së është realizimi i kompetencave sipas ligjit në fuqi, ndërtimi, mbrojtja, konservimi, restaurimi, mirëmbajtja dhe promovimi i Komplekseve dhe Memorialeve të cilat përfaqësojnë të kaluarën e lavdishme të historisë së Kosovës.

3.3. Misioni i AMKMK-së:

Misioni i AMKMK-së është rritja e buxhetit në vitet në vazhdim, ndërtimi i komplekseve dhe memorialeve, zgjerimi i rrjetit të mirëmbajtjes së komplekseve memoriale, rritja e stafit (sipas Rregullores nr. 01/2019 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës).

4. Fushëveprimi që e mbulon Institucioni

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në strukturën organizative nuk ka Bord për shkak se nuk është paraparë sipas Ligjit Nr.04/L-146 të AMKMK-së.

Organi më i lartë ekzekutiv në agjenci është Drejtori. Pra Agjencia udhëhiqet nga Drejtori i Agjencisë i cili është përgjegjës për: Administrimin dhe Menaxhimin e Agjencisë, Organizimin dhe Punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe marrjen e vendimeve për çështjet që u përkasin funksioneve të Agjencisë. Po ashtu, bën menaxhimin efektiv të resurseve që i janë besuar Agjencisë, menaxhimin e Buxhetit të Agjencisë dhe mënyrën e shpenzimit të tij, përfaqësimin e Agjencisë brenda dhe jashtë vendit, lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare në pajtim me ligjet në fuqi si dhe angazhimin e ekspertëve jashtë Agjencisë.

Struktura organizative e AMKMK-së përbëhet nga Zyra e Drejtorit të AMKMK-së dhe dy Departamente:


- Zyra e Drejtorit të AMKMK-së përbëhet nga Auditori i Brendshëm (kjo pozitë nuk është e plotësuar), Çertifikuesi, Divizioni i Prokurimit, Divizioni për Burime Njerëzore dhe Personeli Mbështetës.

Ndërkaq, AMKMK sipas organogramit ka dy Departamente:

- Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme i cili në përbërje të vet ka këto divizione: Divizionin për Buxhet dhe Financa, Divizionin Ligjor, Divizionin për Teknologji informative, GIS dhe Shërbime të Logjistikës, dhe
- Departamentin për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim, i cili ka në përbërjen e vetë ka këto divizione: Divizioni për Planifikim dhe Projekte të Komplekseve dhe Divizioni për Menaxhim të Projekteve. Ky departament ende nuk është funksionalizuar në tërësi për shkak të mungesës së stafit.

Nëpunësit e Agjencisë kanë statusin e Shërbyesve Civil.

4.1. Organogrami i AMKMK-së



4.2. Numri i të Punësuarve në AMKMK - 2021

Në AMKMK janë të punësuar njëzet e një (21) nëpunës në këto kategori funksionale:

Tabela 2. Kategoria e të Punësuarve

Nr.	Kategoritë funksionale	Numri i të punësuarve	Struktura Gjinore	
			M	F
1.	Kategoria e lartë drejtuese	1	1	0
2.	Kategoria e mesme drejtuese	1	1	0
3.	Kategoria e ulët drejtuese	6	3	3
4.	Kategoria profesionale	13	8	5

4.2.1. Nevojat për punëtorë të rinj në AMKMK për vitin 2022

Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, nevojat për punëtorë të rinj janë të domosdoshme ku sipas Ligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Ligji Nr. 04/L-146, AMKMK-ja duhet të ketë 52 punëtor.

AMKMK për vitin 2021 ka kërkuar që të plotësohen pozita të lira të domosdoshme për nevojat e AMKMK-së, por nuk janë aprovuar pozitata me ligjin e Buxhetit për punësime të reja. Po ashtu kemi kërkuar edhe për vitin 2022, por përsëri nuk është aprovuar kërkesa e AMKMK-së.

Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës nevojat për punëtorë të rinj janë të domosdoshme, sidomos në Departamentin për Planifikim dhe Projekte të Komplekseve Memoriale.

Nevojat për punëtor të rinj dhe avancimet në AMKMK parashihen:

Zyra e drejtorit të AMKMK-së:

- Udhëheqës i Divizionit për Auditim - një (1) avancim;
- Zyrtar i Personelit - një (1) rekrutim i jashtëm.

Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim të Komplekseve:

- Udhëheqës i Divizionit për planifikim, Projekte dhe Menaxhim – një (1) avancim;
- Arkitekt - dy (2) rekrutim i jashtëm;
- Inxhinier i Ndërtimtarisë - dy (2) rekrutim i jashtë;

- Ciceron - pesë (5) rekrutim i jashtëm.

Departamenti për Financa dhe Shërbime të përgjithshme:

- Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa – një (1) avancim;

- Zyrtar i Logjistikës – një (1) avancim.

4.3. Asetet

Asetet janë të regjistruara në sistemin SIMFK të Departamentit të Thesarit, sipas Rregullores MF - Nr. 02/2013 – Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore.

Tabela 3. Asetet e AMKMK-së

Klasifikimi i pasurive	Viti 2021 Vlera (€)
Toka (shpronësime)	15,600.00
Pajisjet	112,271.98
Automjetet	7,615.26
Investimet në ndërtimin e Komplekseve Memoriale	12,798,373.83
Gjithsejt	12,933,861.07

AMKMK-ja sipas ligjit obligohet të Menaxhojë me të gjitha asetet e veta në Komplekset Memoriale të Kosovës, përkatësisht investimet kapitale të bëra në këto Memoriale.

Këtij raporti i janë bashkangjitur asetet në detaje si shtojcë në pikën 9 (Shtojca 1).

4.4. Hapësira për punë

Zyret e AMKMK-së janë të vendosura në ndërtesën e objektit të ish-Gjykatës Themelore, me adresë: Rr. Zenel Salihu pn, 10000 Prishtinë. Me numrin e tanishëm të punëtorëve kemi hapësirë të mjaftueshme. Mirëpo, duke pasur parasysh kërkesat e vazhdueshme të këtij institucioni për punëtorë të rinjë, me rritjen e stafit do të jetë e nevojshme të rritet edhe hapësira fizike.

5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese

AMKMK gjatë vitit 2021 ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh, si: Ekzekutimi i punimeve në Komplekse dhe Memoriale sipas Ligjit të Agjencisë Nr.04/L-146, Mirëmbajtja e Komplekseve dhe Memorialeve, realizimi i buxhetit sipas ligjit për buxhet të vitit 2021, realizimi i planit të prokurimit, realizimi i planit të personelit.

Duke pasur parasysh përbërjen e Agjencisë, aktivitetet e implementuara për vitin raportues do të ndahen në bazë të departamenteve.

*Sqarim: Me Rishikim të Buxhetit 2021 AMKMK nuk ka pasur asnjë shkurtim të buxhetit nga buxheti fillestar, vetëm harmonizim / rialokim brenda të të njëjtës kategori ekonomike, përkatësisht investimeve kapitale.

Po ashtu me zbatimin e nenit 9 të Ligjit të Buxhetit 2021 dhe gjatë vitit 2021 AMKMK ka bërë kërkesa për transfer/rialokim të mjeteve brenda një kategorie ekonomike, investime kapitale, pa e ndryshuar shumën totale të buxhetit sipas Ligjit të Buxhetit.

Me Vendim të Qeverisë Nr. 10/46 dt. 30.11.2021, AMKMK ka pasur kursime në kategorinë e shpenzimeve kapitale dhe ndarje të buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Tabela 4. Ndarjet dhe kursimet sipas vendimit Nr. 10/46

Ndarjet:
Mallra e shërbime: 40,000.00€.
Kursimet:
14362 Vazhdimi i punimeve në K.M Beteja e Koshares: 189,000.00€.
14645 K.M Masakra e Reçaku, Shtime: 55,000.00€.
18299 Konservimi i shtëpisë ku është kryer masakra në Poklek të Vjetër: 35,000.00€.
13851 K.M “Adem Jashari”, Prekaz, Skenderaj: 450,000.00€.
14649 K.M ZIV Shtabi i Përgjithshëm, Kleçkë dhe Divjakë: 95,000.00€.
14657 Projekti për intervenime emergjente në komplekse memoriale: 3,249.00€.
18147 Lapidari i Masakrës së Burgut të Dubravës: 5,033.00€.
18299 Konservimi i shtëpisë ku është kryer masakra në Poklek të Vjetër: 25,000.00€.
18658 Lapidari i Elfete Humollit Faza II, Podujevë: 33,000.00€.

18690 Monumenti për batalionin e I-rë të Brigadës 142: 44,665.00€.
--

Me Vendim të Qeverisë Nr. 02/48 dt. 15.12.2021, AMKMK ka pasur kursime dhe ndarje të buxhetit në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Tabela 5. Ndarjet dhe kursimet sipas vendimit nr. 02/48

Kursimet:
15391 K.M Demë Ahmeti, Podujevë: 100,000.00€.
Ndarjet:
14652 K.M Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ZOD, Gllogjan, Deçan: 46,600.00€.
14649 K.M ZIV Shtabi i Përgjithshëm, Kleçkë dhe Divjakë: 11,000.00€.

Me Vendim të Qeverisë Nr. 11/52 dt. 29.12.2021, AMKMK ka pasur kursime në kategorinë e shpenzimeve kapitale dhe paga.

Tabela 6. Ndarjet dhe kursimet sipas vendimit nr. 11/52

Kursimet:
13851 K.M Adem Jashari: 50,000.00€.
14362 Vazhdimi i punimeve në K.M Beteja e Koshares: 10,398.85€.
14649 K.M ZIV Shtabi i Përgjithshëm, Kleçkë dhe Divjakë: 30,666.67€.
14653 K.M Shtabi i varrezave të dëshmorëve të UÇK-së, Shqiponje, Gjakovë: 43,799.50€.
14657 Projekti për intervenime emergjente në Komplekse Memoriale: 41,492.32€.
15044 Memoriali Meje- Gjakovë: 68,153.40€.
18632 K.M Masakra e Krushës së Vogël, Prizren: 50,000.00€.
18692 Rregullimi i rrethojës së varrezave të dëshmorëve në Ranzë, Shtime: 2,599.99€.
Pagat: 15,764.69€.

5.1. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2021:

5.1.1 Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Në kuadër të këtij departamenti janë zhvilluar këto aktivitete:

- Ekzekutimi i buxhetit për vitin 2021, 98% e buxhetit është shpenzuar;
- Planifikimi buxhetor për vitin 2022 sipas Qarkoreve Buxhetore të MFPT;
- Marrëveshje bashkëpunimi me organet komunale, qendrore, organizata të dala nga lufta dhe OJQ;
- Realizimi i shërbimeve të logjistikës;
- Mirëmbajtja dhe administrim i sistemit informativ të Agjencisë (Interneti, telefoni, Web Faqja, Fan page);
- Mbështetja teknike për nevojat e stafit të Agjencisë;
- Shërbimet e TI për nevojat e Agjencisë;
- Menaxhimi i nevojave të transportit të Agjencisë;
- Realizimi i projektit të GIS-it për të dhënat e Komplekseve, Memorialeve, Lapidarëve, Varrezave të Dëshmorëve dhe Martirëve, Shtatoreve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

5.1.2. Divizioni për Buxhet dhe Financa

Në kuadër të këtij divizioni janë zhvilluar këto aktivitete:

- Hartimi i kërkesave Buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore 01/2022; 02/2022 duke përfshirë planifikimin e buxhetit operativ në sistemin BDMS;
- Hartimi i Raporteve dhe Pasqyrave Financiare Vjetore 2021 dhe Raporteve Financiare tre mujore, gjashtëmujore dhe nëntëmujorë të AMKMK-së;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2022-2024 të AMKMK-së;
- Barazimi i shpenzimeve dhe procesi i rikonsulidimit të AMKMK-së dhe Departamentit të Thesarit për çdo muaj;
- Raportimi i obligimeve të papaguara dhe obligimeve kontraktuale gjatë vitit 2021;
- Zotimi i mjeteve, aprovimi i tyre dhe shpenzimet e pagesave në SIMFK 2021;
- Regjistrimi i pasurive kapitale mbi 1,000.00 € në SIMFK;
- Regjistrimi i pasurive nën 1,000.00 € në programin E-pasuria;
- Menaxhimi i petty cashit.

5.1.3.Divizioni Ligjor

Në kuadër të këtij divizioni janë zhvilluar këto aktivitete:

- Koordinimi i aktiviteteve me të gjitha strukturat organizative të Agjencisë për zbatimin e legjislacionit;
- Ofrimi i mbështetjes ligjore në fushën e legjislacionit;
- Identifikimi i problemeve në zbatimin e akteve normative;
- Ofrimi i mbështetjes ligjore në hartimin e propozim-vendimeve, propozim-marrëveshjeve, propozim memorandumeve dhe propozim- kontratave;
- Koordinimi i aktiviteteve legjislative të Agjencisë me institucionet përkatëse;
- Përfaqësime në Seanca lidhur me kontestet gjyqësore;

5.1.4.Divizioni për TI, GIS dhe Logjistikë

- Mirëmbajtja e bazës së të dhënave, routerave, switch-at, dhe rrjetën mobile;
- Mirëmbajtja e sistemit: e-malit zyrtar, operimi me rrjeta, si dhe instalimi i pajisjeve të TI-së;
- Përcaktimi i llojit, tipit dhe karakteristikave për furnizimin me pajisje të TI-së;
- Kërkesat për numëra të ri, si dhe transferim të numrave aktual të Telefonave;
- Kërkesat për hapjen e e-mailit për zyrtar të ri;
- Përkrahja teknike me probleme të ndryshme që mund të paraqiten.
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i të dhënave në programin për Menaxhimin e Flamujve;
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i bazës së të dhënave në Sistemin GIS;

5.1.5. Divizioni i Prokurimit:

Përkundër që ishte një vit sfidues duke marrë parasysh që OSHP nuk ishte funksionale (OE duke pas parasysh këtë situatë në shumë raste edhe pa të drejtë kanë berë ankesë vetëm e vetëm për të penguar realizimin e AP) si dhe pandeminë Covid 19. Divizioni i Prokurimit ka arritë të realizoj objektivat dhe aktivitetet e parapara për vitin 2021.

- Ekzekutimi i planit të prokurimit për vitin 2021;
- Planifikimi i prokurimit për vitin 2022.

Procedurat e prokurimit që janë zhvilluar për vitin 2021

AMKMK gjatë periudhës së vitit 2021 ka zhvilluar një sërë të aktiviteteve, këto janë:

1. Procedurat për furnizim;
2. Procedurat për shërbime;
3. Procedurat për punë;
4. Procedurat e projektimit.

Procedurat për furnizim

1. Furnizim me material shpenzues (kimikë, fletore, kalendar artikujt të jenë me llogo të AMKMK-së) për nevojat e AMKMK-së.

Procedurat për shërbime

1. Ofrimi i një Kompanie Profesionale për Matjet në Gjeo-Mekanike në K.M. Masakra e Reçakut, Reçak – Shtime;
2. Mirëmbajtja e K .M. “Dëshmorët e UÇK-së” Penuhë – Podujevë;
3. Hartimi i Projektit për Ngritjen e Lapidarit në K M “Beteja e Koshares” Koshare;
4. Mirëmbajtja e Memorialëve të UÇK-së në Likovc- Shtabi i UÇK-së dhe Varrezat e Dëshmorëve, Likoshan dhe Qirez, Izbicë dhe Rezallë ” Skenderaj dhe Drenas;
5. Ofrimin e një konsulenti (ligjor) të jashtëm për nevojat e AMKMK-së;
6. Hartimi i Projektit për Ndërtimin e Urës në K M “Beteja e Koshares” Koshare;
7. Mirëmbajtja dhe riparimi i veturave zyrtare;
8. Ofrimin e një Arkitekti për nevojat e AMKMK-së;
9. Sigurimi Fizik për KM. Beteja e Koshares – Koshare, Gjakovë.

Procedurat për punë:

Gjatë vitit 2021, AMKMK-ja ka zhvilluar një sërë aktivitetesth të cilat kanë rezultuar me ndërtimin e disa objekteve Memoriale në tërë territorin e Kosovës të cilat menaxhohen nga AMKMK-ja. Krahasuar me vitet paraprake, është rritur numri i Komplekseve Memoriale që janë ndërtuar dhe që do të ndërtohen në vazhdim (projektet dy dhe tre vjeçare).

1. Punët shtesë në projektin: Punët shtesë në projektin “Ndërtimi i Memorialëve, “Memoriali i Dëshmorëve në Nivokaz, Gjakovë, “Ndërtimi i Lapidarëve të Dëshmorit Abedin Bujupi dhe Ymer Alushani – Drenas;
2. Ekzekutimi i Fazës së Katërt IV në K M “27 Prilli” Meje- Gjakovë - (Lënda në OSHP);
3. Ndërtimi i Bazamentit për Vendosjen e Busteve të Heronjëve Emin, Nebih, Tahir dhe Beqir Meha në Prekaz;
4. Ndërtimi i Memorialit të Tre Dëshmorëve të Nekovcit – Nekovc, Drenas;
5. Intervenime Emergjente në Disa Memoriale të Komunës së Drenasit dhe Obiliqit;
6. Punët Shtesë në “Ekzekutimi i Punëve në KM. Masakra e Raçakut – Raçak, Shtime, faza e III-të”;
7. Ndërtimi i Bazamentit të Shtatores së Heroit Dr. Hafir Shala – Drenas;
8. Restaurimi i Bustit të Dëshmorit “Safet Rexhepi” në Zhiti – Viti;
9. Realizimi i projektit Liria ka Emër për figurën e Gjeneral “Xheladin Gashit-Plaku” – Komoran, Drenas;
10. Ndërtimi i Kompleksit Memorialit të Dëshmorëve në Morinë, Gjakovë ;
11. Zhvendosja e konstruksionit të mbulesës së Kontejnerëve tek Shtatorja e Hafir Shalës;
12. Ndërtimi “Arkivi i UÇK-së, ZOLL - Sektori i Shëndetësisë në Penuhë dhe Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit Rushit R. Selmani- Llapashticë, Podujevë;
13. Renovimi i Memorialeve:- Në Fshatin Dobrushtë- Prizren, - Gorozhub, Prizren, - Strazhë Kaçanik -(Lënda në OSHP);
14. Vazhdimi i punimeve faza e -II-të - Shtatorja e Heroit Dr.Hafir Shala” Drenas;
15. Ndërtimi i Monumentit për Batalionin e I-rë të Brigadës 142 të UÇK-së, Gllavotin - Vushtrri, Faza e -I- (Lënda në OSHP);
16. Vazhdim i punëve “Ndërtimi i Memorialit të Tre Dëshmorëve të Nekovcit” – Nekovc, Drenas;
17. Ekzekutimi i Punëve - Ndërtimi i Fazës së IV-të - “Beteja e Koshares”, Koshare - (Lënda në OSHP);
18. Gravimi i emrave dhe fotot e Dëshmorëve Marec- Prishtinë dhe Rregullimi i fotografisë së Komandantit Adem Jashari, Prekaz - Skenderaj;

19. Punët Shtesë në projektin “Ndërtimin e Lapidarit të Masakrës së Burgut të Dubravës - Istog” – vazhdim i punimeve;
20. Konservimi dhe Restaurimi i Disa Objekteve të Luftës së UÇK-së dhe Objekteve ku janë Kryer Masakrat –Shtime dhe Lipjan;
21. Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit Skender Shala- Vuçak, Drenas, Renovimi i hapësirës përreth shtatores së dëshmorit Enver Kukaj- Tërstenik, Drenas, Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit Ahmet Pantina- Llazicë, Malishevë - Ritender;
22. Ekzekutimi i Punëve në projektin “Lapidari i Ylfete Humollit - Faza e II-të” - (Lënda në OSHP);
23. Renovimi i lapidarit të dëshmorit Bedri S. Bajrami (Komandant Beni)- Majac, Podujevë, Renovimi i lapidarit të dëshmorit Shahin Gashi - Kaqandoll, Podujevë dhe Renovimi i lapidarit të dëshmorit Isuf Ferizi - Prapashticë, Prishtinë –Ritender;
24. Ekzekutimi i Punëve në “ZIV “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK - së Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës” - Ndërtimi i Rrethojës së Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së – Kleçkë” ;
25. Ndërtimi i Bazamentit të Shtatores së Heroinës Kombëtare “ Mervete Maksutaj ” – Pejë;
26. Ndërtimi i rrethojës së Memorialit të Dëshmorëve në Nekovc - (Lënda në OSHP);
27. Punët Shtesë në Konservimin dhe Ndërtimi i “Kompleksit Memorial - Historik - Shtabi i ZOD të UÇK-së dhe Muzeut në Gllogjan, - Faza e II-të;
28. Punët Shtesë në projektin ”Rregullimi i Memorialit të Martirëve, Rancë- Shtime;
29. Punët Shtesë në projektin: Ekzekutimi i Punëve në ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë - Malet e Berishës” - Ndërtimi i Rrethojës së Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së Kleçkë”;
30. Punët Shtesë në projektin ”Konservimi dhe Restaurimi i disa objekteve të luftës së UÇK-së dhe objekteve ku janë kryer masakrat – Shtime dhe Lipjan”.

Procedurat e projektimit:

1. Ndërtimi i Busteve të Heronjve Emin, Nebih, Tahir dhe Beqir Meha – Prekaz;
2. Ndërtimi i Shtatores së Heroinës Kombëtare “Mervete Maksutaj”- Pejë;
3. Ndërtimi i Busteve të tre dëshmorëve të Nekovcit – Nekovc, Drenas.

5.1.6. Divizioni i Burimeve njerëzore

Në kuadër të këtij divizioni janë zhvilluar këto aktivitete:

- Menaxhimi i pushimeve vjetore, mjekësore dhe të lehonisë;
- Gjatë vitit 2021 kemi pasur një dorëheqje nga shërbimi civil dhe me lirimin e pozitës Ciceron është hapur konkurs i brendshëm lëvizje paralele, por në mungesë e aplikimeve konkursi ka dështuar. Kemi vazhduar me shpalljen e konkursit pranimi i jashtëm, procedurat e rekrutimit ka vazhduar deri në muajin e parë të vitit 2022 ku edhe është mbyllur me akt emërimin e kandidatit më të suksesshëm. Pozita tjera të lira nuk kemi pasur, arsyeja nuk janë aprovuar me Ligjin e buxhetit për vitin 2021.

-Tabela 7. Tabela e trajnimeve 2021

Nr.	Nr. i punëtorëve të trajnuar	Fusha e Trajnimit	Ofruesi i trajnimit
1.	10	Legjislacion	IKAP
2.	1	Buxhet dhe Financa	IKAP
3.	2	Prokurim	IKAP/FLSA
4.	1	GIS	AUK

5.1.7. Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim:

Në kuadër të këtij departamenti janë zhvilluar këto aktivitete:

- Hartimi dhe projektimi i projekteve;
- Menaxhimi i projekteve kapitale dhe atyre të mirëmbajtjes;
- Mbikqyrja në terren e projekteve;
- Analizimi dhe vlerësimi i projekteve të ndryshme;
- Pranimi teknik i punimeve.

Projektet që janë menaxhuar në vitin 2021 janë:

1. Kompleksi Memorial “Adem Jashari” - Prekaz, Skënderaj (mirëmbajtja);
2. Kompleksi Memorial “ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë- Malet e Berishës (mirëmbajtja) dhe ndërtimi i Rrethojës së Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së -Kleçkë;
3. Kompleksi Memorial “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së - Marinë, Skenderaj (mirëmbajtja);
4. Kompleksi Memorial “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së, Penuhë- Podujevë (mirëmbajtja);
5. Ndërtimi i Kompleksit Memorial “Masakra e Raçakut”, Raçak- Shtime (faza e III-të- ekzekutim i punimeve dhe mirëmbajtja);
6. Kompleksi Memorial “Kulla e Zahir Pajazitit” Orllan - Podujevë (mirëmbajtja);
7. Kompleksi Memorial “Dëshmorët e Kombit” Vrellë - Istog (mirëmbajtja);
8. Memoriali “Masakra e familjes Ahmeti” - Likoshan, Drenas (mirëmbajtja);
9. Kompleksi Memorial “27 Prilli” – Meje, Gjakovë (Ekzekutim i punimeve faza e III-të dhe mirëmbajtja);
10. Kompleksi Memorial “Demë Ahmeti”, Podujevë (procedurat e shpronësimit);
11. Mirëmbajtja e Kompleksit Memorial “Baza e Parë e UÇK-së” - Lladovc, Podujevë (mirëmbajtja);
12. Ndërtimi i Kompleksit Memorial “Shtabi i Përgjithshëm i ZOD-it” Gllogjan- Deçan (ekzekutimi i punimeve faza e I- dhe II-të);
13. Memoriali “Dëshmorët e UÇK-së” – Shqiponjë, Gjakovë (vazhdim i punimeve);
14. Memorialet “Masakra e Izbicës, Rezallës, Likovcit dhe Likoshanit”, Skenderaj dhe Drenas (mirëmbajtja);
15. Shtabi dhe Varrezat e Dëshmorëve në Kostërc - Skenderaj (procedurat e shpronësimit);
16. Memoriali i Martirëve - Dyz, Podujevë (ekzekutim i punimeve faza e -II- dhe mirëmbajtja);
17. Memoriali i Dëshmorëve – Kaqanoll, Podujevë (mirëmbajtje);
18. Lapidari i Masakrës së Burgut të Dubravës – Istog (ekzekutim i punimeve);
19. Lapidari i Dëshmorëve, Korroticë e Epërme – Drenas (ekzekutim i punimeve);

20. Lapidari “Zahir Pajaziti” - Pestovë, Vushtrri (mirëmbajtje);
21. Memoriali i Martirëve - Studime, Vushtrri (ekzekutim i punimeve);
22. Rregullimi i shtatores së Isa Kastratit dhe renovimi i Lapidarëve - Kamenicë (ekzekutim i punimeve);
23. Ndërtimi i Pllakës për Heroin Hoxhë Avdyli Krasniqi në Vojnik- Skenderaj (ekzekutim i punimeve);
24. Renovimi i Kompleksit Memorial në fshatin Marec - Prishtinë (ekzekutim i punimeve);
25. Rregullimi i Lapidarit në Kaliqan - Istog (ekzekutim i punimeve);
26. Memoriali “Masakra në Kamenicë” - Istog (ekzekutim i punimeve);
27. Lapidari i Dëshmorëve dhe Martirëve në Zahaq- Pejë (ekzekutim i punimeve);
28. Lapidari i “Elfete Humollit” Faza I - Podujevë (ekzekutim i punimeve);
29. Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së dhe Derdhja në Bronz i Busteve të Gursel e Bajram Sylejmanit –Sadovinë, Viti (ekzekutimi i punimeve Faza e -II- të);
30. Muzeu “Kadri Zeka” - Kamenicë (ekzekutim i punimeve);
31. Ndërtimi i memorialit në Retijë, Rahovec (ekzekutim i punimeve, bashkëpunim me KK Rahovec);
32. Lapidari i Dy Nxënësve të Vrarë - Shtedim, Podujevë (ekzekutim i punimeve);
33. Lapidari i Dëshmorëve Hajdin Haliti e Sami Plakolli - Orllan, Podujevë (ekzekutim i punimeve);
34. Memoriali i Betejës së Pollatës - Podujevë (ekzekutim i punimeve);
35. Ndërtimi i Memorialit të Dëshmorëve në Nivokaz –Gjakovë (ekzekutim i punimeve);
36. Ndërtimi i Lapidarit të Dëshmorit Abedin Bujupi – Drenas (ekzekutim i punimeve);
37. Ndërtimi i Lapidarit Ymer Alushani – Drenas (ekzekutim i punimeve);
38. Ndërtimi i Bazamentit për Vendosijen e Busteve të Heronjve Emin, Nebih, Tahir dhe Beqir Meha në Prekaz (ekzekutim i punimeve);
39. Ndërtimi i Memorialit të Tre Dëshmorëve të Nekovcit – Nekovc, Drenas (ekzekutim i punimeve);
40. Intervenime Emergjente në disa Memoriale të Komunës së Drenasit dhe Obiliqit (Qikatovë e Vjetër, Gllanasellë, Abri e Epërme, Poklek i Vjetër, Vasilevë, Zhilivodë) (ekzekutim i punimeve);

41. Ndërtimi i Bazamentit, Shtatores së Heroit Dr. Hafir Shala dhe hapësirës përreth – Drenas (ekzekutim i punimeve);
42. Realizimi i projektit Liria ka Emër në punim të kalitet figura e Gjeneral “Xheladin Gashi-Plaku” – Komoran, Drenas (vepër artistike);
43. Ndërtimi Arkivi i UÇK-së, ZOLL - Sektori i Shëndetësisë në Penuhë(ekzekutim i punimeve);
44. Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit Rushit R. Selmani- Llapashticë, Podujevë (ekzekutim i punimeve);
45. Gravimi i emrave dhe fotot e Dëshmorëve Marec- Prishtinë dhe Rregullimi i fotografisë së Komandantit Adem Jashari, Prekaz- Skenderaj(ekzekutim i punimeve);
46. Konservimi dhe Restaurimi i Disa Objekteve të Luftës së UÇK-së dhe Objekteve (shtëpia e masakrës Reçak, Mulliri – Shalë, Shtabi i UÇK-së – Leletiq) ku janë Kryer Masakrat –Shtime dhe Lipjan (projektim dhe ekzekutim i punimeve);
47. Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit Skender Shala- Vuçak, Drenas (ekzekutim i punimeve);
48. Renovimi i hapësirës përreth shtatores së dëshmorit Enver Kukaj- Tërstenik, Drenas (ekzekutim i punimeve);
49. Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit Ahmet Pantina- Llazicë, Malishevë (ekzekutim i punimeve);
50. Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit Bedri S. Bajrami (Komandant Beni)- Majac, Podujevë (ekzekutim i punimeve);
51. Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit Shahin Gashi- Kaqandoll, Podujevë (ekzekutim i punimeve);
52. Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit Isuf Ferizi- Prapashticë, Prishtinë (ekzekutim i punimeve);
53. Ndërtimi i Bazamentit të Shtatores së Heroinës Kombëtare “ Mervete Maksutaj ” – Pejë (projektim dhe ekzekutim i punimeve);
54. ”Rregullimi i Memorialit të Martirëve, Rancë- Shtime” (ekzekutim i punimeve);
55. Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së - Junik (ekzekutim i punimeve, bashkëpunim me K.K Junik);

56. Memoriali “Masakra e Krushës së Madhe” Krushë, Rahovec (ekzekutim i punimeve, bashkëpunim me K.K. Rahovec);
57. Renovimi i Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve në Komunën e Suharekës (ekzekutim i punimeve, bashkëpunim me K.K. Suharekë);
58. Ndërtimi i Busteve të Heronjve Emin, Nebih, Tahir dhe Beqir Meha – Prekaz, Skenderaj;
59. Ndërtimi i Shtatores së Heroinës Kombëtare “Mervete Maksutaj”- Pejë;
60. Ndërtimi i Busteve të tre Dëshmorëve të Nekovcit – Nekovc, Drenas.

5.2.Planet që parashikohen për vitin 2022

Duke pasur parasysh organizimin e Agjencisë, planet e parashikuara për vitin 2022, i paraqesim në bazë të departamentëve:

5.2.1.Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

- Realizimi i projekteve të paraparë me Ligjin e Buxhetit 2022 (Shtojca 2);
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve MFPT dhe me Ministrinë e Mjedisit dhe Infrastrukturës për shpronësimin e pronave ku gjenden Komplekset dhe Memorialet;
- Bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe OJQ;
- Hartimi i projektstrategjisë dhe planit të veprimit të Agjencisë;
- Hartimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve për Komplekset Memoriale të Kosovës;
- Rritja buxhetit dhe numrit të puntorëve;
- Mirëmbajtja e Web faqes së AMKMK-së;
- Funksionalizimi i procesit të të hyrave vetanake në K.M “Adem Jashari” - Prekaz;
- Sigurimi dhe mirëmbajtja e projekteve të Teknologjisë Informative me interes të AMKMK-së (Sigurimi i rrjetit, telefonit, mirëmbajtja e bazës së të dhënave, routerave, switch-it, dhe rrjetën mobile);
- Mirëmbajtëse e sistemit: e-malit zyrtar, operimi me rrjeta, si dhe instalimi i pajisjeve të IT-së;

- Mirëmbajtja dhe përditësimi i bazës së të dhënave në Sistemin GIS (Përditësimi i bazës së të dhënave GIS, shpërndarja dhe sinkronizimi i të dhënave nga Baza e GIS në webfaqe).

5.2.2. Divizioni për buxhet dhe financa

Aktivitetet që do të kryhen në kuader të këtij divizioni janë:

- Hartimi i rrjedhës së parasë për vitin 2022, për kategorinë paga & mëditje, mallra e shërbime dhe investime kapitale;
- Procedimin e pagesave, obligimeve, zotimin, shpenzimet sipas afatit ligjor;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025 të AMKMK-së;
- Hartimi i Raportit Vjetor Financiar 2022 për Kuvendin e Kosovës;
- Raporti dhe pasqyrat financiare 2022 tre mujore, gjashtë mujore dhe nëntëmujore të AMKMK-së;
- Hartimi i kërkesave Buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore 01/2023; 02/2023 dhe 03/2023 duke përfshirë planifikimin e buxhetit operativ në sistemin BDMS dhe planifikimin e projekteve kapitale në sistemin e PIP-it;
- Hartimi i kërkesave për transfere dhe rialokime të mjeteve sipas Udhëzimit Administrativ 05/2019;
- Dorëzimi i kërkesës buxhetore të AMKMK-së për rishikimin buxhetor 2022 në Ministrinë e Financave;
- Regjistrimi i pasurive në sistemin SIMFK dhe E-pasuria;
- Përmbyllja e vitit fiskal sipas Rregullores 01/2018;
- Punë të tjera të cilat kërkohen sipas Ligjit të Buxhetit 2022 dhe Rregulloreve Financiare në fuqi për vitin fiskal 2022.

5.2.3. Divizioni Ligjor

Aktivitetet e legjislacionit që parashihen për vitin 2022 janë:

- Hartimi i Projekt Rregullores për Përcaktimin e Kritereve për Komplekset Memoriale të Kosovës;
- Plani për Menaxhimin e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz;
- Hartimi i Projekt Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AMKMK-së;

- Nxjerrja e Akteve nënligjore sipas Ligjit Nr.04/L-146 AMKMK dhe Ligjit Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- Përpilimi i Vendimeve në sfera të ndryshme në Agjenci;

5.2.4. Divizioni për TI, GIS dhe Logjistikë

- Instalimi dhe menaxhimi i sistemit të video vëzhgimit në disa Komplekse më të rëndësishëm;
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i bazës së të dhënave në sistemin GIS;
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i të dhënave në programin për menaxhmin e flamujëve;
- Përkrahje teknike për stafin e AMKMK-së;
- Mirëmbajtja e projekteve të TI-së me interes për AMKMK-në;
- Mirëmbajtja dhe servisimi i veturave të Agjencisë;

5.2.5. Divizioni i Prokurimit

Në kuadër të Divizionit të Prokurimit do të kryhen këto aktivitete:

1. Procedurat për punë;
 2. Procedurat për furnizim dhe shërbime;
 3. Procedurat për konkurse të Projektimit;
- Në konsultim me të gjitha departamentet apo njësitë e kërkesës përgatitë një plan vjetorë të prokurimit dhe vendos kërkesat sipas prioritetit;
 - Hartimi i planit paraprak apo preliminar të aktiviteteve të prokurimit që kanë për t'u zhvilluar në vitin 2022;
 - Menaxhimi me arkivimin dhe sistemimin e dokumenteve të prokurimit;
 - Informimin publik dhe hartimin e raporteve të ndryshme;
 - Zhvillimi i platformës elektronike të e-prokurimit;
 - Mirëmbanë dhe arkivon të dhëna për prokurime;
 - Menaxhimi me zyrën e prokurimit, harmonizimi i punëve me Sektorin për Buxhet dhe Financa.

5.2.6. Divizioni i Burimeve Njerëzore

Aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit 2022 do të jenë:

- Menaxhimi i pushimeve vjetore, mjekësore dhe të lehonisë;
- Implementimi i planit të trajnimeve;
- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit.

Tabela 8. Plani vjetor i trajnimit i nënpunësit civil për periudhën Janar – Dhjetor 2022

Nr.	Nr. i punëtorëve të trajnuar	Fusha e Trajnimit	Ofruesi i trajnimit
1.	4	Menaxhim i Përgjithshëm	
2.	3	Trajnime nga fusha e Burimeve Njerëzore	
3.	2	Legjislacion	
4.	3	Buxhet dhe Financa	
5.	2	Prokurim	
6.	2	TI dhe Logjistikë	
7.	2	Arkitekturë dhe Ndërtimtari	
8.	2	Arkivë	

5.2.7. Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim

- Rritja e stafit profesional në këtë departament;
- Menaxhimi i projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2022 (Shtojca 2);
- Menaxhimi i kontratave të mirëmbajtjes;
- Mbikëqyrja e punimeve ndërtimore;
- Analizimi dhe revidimi i projekteve;
- Projektimi i projekteve detale për nevojat e Agjencisë.

5.3. Përmirësimet dhe monitorimi i fushës së veprimit

- Është bërë zgjerimi i rrjetit të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së Komplekseve dhe Memoriale në nivel vendi krahasuar me vitet paraprake;
- Kemi finalizuar databazën në sistemin e GIS-it për të dhënat rreth komplekseve, memorialeve, lapidareve, shtatoreve dhe busteve, varrezave të dëshmorëve dhe martirëve, objekteve të trashëgimisë së luftës në nivel vendi;
- Është menaxhuar suksesshëm sistemi i programit të flamujëve;
- Është rritur numri i investimeve kapitale në objektet e luftës;
- Është bërë konservimi dhe restaurimi i disa objekteve të luftës;
- Është bërë mirëmbajta dhe përditësimi i të dhënat në Web Faqe.

6. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / Sfidat e Institucionit (Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit)

Agjencia ka linjë të pavarur buxhetore duke iu përmbajtur Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Sfidat e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale kryesisht kanë të bëjnë me fushëveprimin dhe misionin e kësaj agjencie. Sfidat kryesore gjatë vitit të kaluar të cilat vazhdojnë edhe këtë vit janë:

- Problemi i shpronësimit, ku shumë projekte kanë dështuar ose kanë ngecur shkaku i kësaj problematike (shih tabelën 9).
- Bazuar në numrin e madh të Komplekseve dhe Memorialeve që presin për t'u ndërtuar, për të bërë nderhyrje emergjente në objekte ekzistuese dhe për t'u mirëmbajtur, kemi mungesë të theksuar të buxhetit.
- Sfidë tjetër është edhe mungesa e stafit profesional sidomos në Departamentin për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim të Komplekseve. Pasi që fushëveprimi i Agjencisë është kryesisht në ndërtim, rindërtim, menaxhim dhe promovim të Komplekseve dhe Memorialeve, kemi mungesë të personelit profesional: arkitekt, inxhinier të ndërtimit dhe ciceronë, ku dihet se në Kompleksin Memorial Adem Jashari janë vetëm dy ciceronë, të cilët nuk arrijnë as përafërsisht t'i mbulojnë kërkesat e vizitorëve.
- Rritja e buxhetit për projekte kapitale;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime;
- Është e domosdoshme rritja e buxhetit për shpenzime komunale me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrimeve, sepse ndarja e mjeteve buxhetore në këtë linjë nuk i mbulon shpenzimet për të gjitha Komplekset dhe Memorialet.

Tabela 9. Komplekset memoriale, pronat e të cilëve kanë probleme të shpronësimit

Kompleksi Memorial	Zona Kadastrale	Komuna
“Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës”, Shtëpia dhe Bunkeri i “Radio Kosova e Lirë;	Berishë	Malishevë
“Masakra e Likoshanit”	Likoshan	Drenas
“Dëshmorët e Kombit”	Vrellë	Istog
“Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së- Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës, spitalet e UÇK-së, Qendra protokollare;	Zona Kadastrale- Divjake	Lipjan
Shtabi i Brigades 121, Pushimorja e Fëmijëve dhe Fshati i UÇK-së;	Kleçkë	Lipjan
Shtëpia e Delegacionit të Rambujesë - Qeveria e Përkohshme në Novosellë	Tërpezë	Malishevë
Mulliri i UÇK-së	Shalë (ish Sadllari)	Lipjan
Shtabi i Komandant Kumanova	Luzhnicë	Suharekë
